

ILD ZHVILLOI VIZITË PUNE NË LONDËR

Faqe 2-4

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani ishte për një vizitë pune në Londër, ku zhvilloi takime me përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, institucioneve të tjera publike dhe me një komunitet profesionistësh britaniko-shqiptarë.



ILD në shifra

64 vendime nga 139 praktika të trajtuara:
51 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar
13 vendime arkivimi pas verifikimit

19 vendime verifikimi

1 vendim për fillim hetimi disiplinor
për 1 magjistrat (gjyqtar)

Qytetari në Zyrën e ILD-së

Gjatë muajit Shkurt 2026:

- janë pritur **41 ankues**, të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- janë realizuar **39 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës;
- janë trajtuar **24 kërkesa** për informacion.



Monitorimi i efencës gjyqësore dhe i zbatimit të rekomandimeve, ILD miraton kalendarin e inspektimeve për vitin 2026
Fq. 5-6



ILD përfundon verifikimin për zbatimin e ligjit për amnistinë, të vitit 2024
Fq. 7

KL GjJ pranon pjesërisht kërkesën e ILD për masë disiplinore ndaj magjistratit Sh.L
Fq. 10

ILD mori pjesë në tryezën ndër institucionale për klimën dhe drejtësinë mjedisore në Shqipëri
Fq. 11-13

Inspektori i Lartë i Drejtësisë zhvilloi një vizitë pune në Maqedoninë e Veriut
Fq. 14-15

Trupa inspektuese e ILD trajnim mbi metodat e reflektimit profesional dhe dilemave etike
Fq. 16-17

Mbledhja e inspektorëve angazhohet për zbatimin e metodologjisë së verifikimit të aseteve
Fq. 18

ILD ZHVILLOI VIZITË PUNE NË LONDËR



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani ishte për një vizitë pune në Londër, ku zhvilloi takime me përfaqësues të institucioneve të drejtësisë, institucioneve të tjera publike dhe me një komunitet profesionistësh britaniko-shqiptarë. Vizita kishte si qëllim ndërtimin dhe forcimin e marrëdhënieve profesionale mes Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar në fushën e Drejtësisë, përmes shkëmbimit të ideve dhe praktikave më të mira të punës, në funksion të rritjes së efikasitetit dhe cilësisë së sistemit të Drejtësisë në Shqipëri.

Me ftesë të Shoqatës së Juristëve Britaniko-Shqiptarë (BALA) në Londër, z. Metani mori pjesë në eventin e organizuar në formë bashkëbisedimi me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, nën kujdesin e kryetares së BALA-s, znj. Brikena Muharremi dhe Ambasadorit të Shqipërisë në Londër, z. Uran Ferizi. Në fillim, z. Metani bëri një paraqitje të rolit dhe funksioneve të institucionit që drejton, si dhe të punës së kryer gjatë këtyre gjashtë viteve të para të detyrës.

Më tej, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani, iu përgjigj interesit të lartë të pjesëmarrësve, duke trajtuar çështje, që nga aspektet konkrete të punës së institucionit, si trajtimi i ankesave, hetimi dhe procedimi disiplinor i gjyqtarëve dhe prokurorëve, apo inspektimet në gjykata e prokurori, e deri tek interesimi mbi dinamika aktuale të sistemit të drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve.

Bazuar në interesin e lartë të studentëve të drejtësisë dhe juristëve të rinj, z. Metani shpalli vullnetin për t'i mirëpritur pranë ILD-së në Tiranë, si në programe intershipi profesional, ashtu edhe në mundësi punësimit.

Gjatë kësaj vizite pune, Inspektori i Lartë i Drejtësisë u mikprit në Gjykatën e Lartë të Mbretërisë së Bashkuar nga gjyqtarja e lartë Dame Vivien Rose (Lady Rose) dhe ish-gjyqtari Sir Stephen John Irëin, drejtues i Slynn Foundation. Biseda u fokusua tek praktika e punës së Gjykatës së Lartë britanike mbi procesin e hetimit të sjelljes gjyqësore, si dhe modeli shqiptar i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke bashkëndarë ide mbi mundësi bashkëpunimi e shkëmbimeve profesionale.

Z. Metani dhe delegacioni që e shoqëronte u mikpritën në Parlamentin Britanik nga deputeti Martin Vickers, kryetar i grupit të përbashkët të miqësisë me Shqipërinë dhe Kosovën në parlamentin britanik. Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e Shqipërisë në proceset integruuese e reformat institucionale për shtetin e së drejtës, si dhe u nënvizua mbështetja e vazhdueshme e Mbretërisë së Bashkuar dhe vullneti për forcimin e bashkëpunimit dypalësh.

Pjesë e vizitës ishte edhe një takim në Ambasadën e Kosovës në Londër, ku delegacioni i ILD-së u prit nga ambasadori Ilir Kapiti. Praktika e mirë e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave mes institucioneve të drejtësisë së Shqipërisë dhe Kosovës ishte në qendër të bashkëbisedimit, në funksion të forcimit të kapaciteteve institucionale të dy vendeve.

Vizita e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe e delegacionit që e shoqëronte, u organizua nga Open Gov Hub Albania.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
BULETINI MUJOR





MONITORIM I EFICIENCËS GJYQËSORE DHE I ZBATIMIT TË REKOMANDIMEVE, ILD MIRATON KALENDARIN E INSPEKTIMEVE PËR VITIN 2026



Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve, më 30 2026, planin e inspektimeve në prokurori e gjykata për vitin 2026.

Inspektimet tematike dhe institucionale do jenë edhe gjatë vitit 2026, instrumenti me të cilin Inspektori i Lartë i Drejtësisë mat eficientësinë e drejtësisë në vend, ndërsa këtë vit, në mënyrë të dedikuar, do të monitorojë edhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga inspektimet të mëparshme.

Në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve u paraqit analiza e të dhënave mbi llojin e pretendimeve të ankuesve, qytetarë apo institucione deri në dhjetor 2025, si dhe pretendimet e ankesave të trajtuara me vendimarrje gjatë vitit 2025. Sipas të dhënave, pjesën më të madhe e zenë pretendimet për vendimarrje të padrejta, pretendimet për zvarritje gjykim,

zvarritje të veprimtarisë hetimore dhe vonesa në dorëzimin e vendimeve gjyqësore.

Në Mbledhjen e Përgjithshme të Inspektorëve u evidentua se gjatë vitit 2025, sipas traditës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i ka dërguar kërkesa për tematika inspektimesh për planin e inspektimeve për vitin 2026, institucioneve të drejtësisë, Prokurorit të Përgjithshëm, Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Ministrin të Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Avokatisë.

Në mbledhje u vlerësua angazhimi i tri institucioneve, që kanë përcjellë propozime për inspektimet tematike ose institucionale, konkretisht Prokurori i Përgjithshëm ka propozuar 2 tematika inspektimesh, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, 4 tematika inspektimesh dhe Ministri i Drejtësisë 5 tematika inspektimesh.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BULETINI MUJOR

Pas diskutimeve mbi të dhënat e ankesave të përcjella, të propozimeve të ardhura nga tri institucionet e drejtësisë, si dhe të prioritetëve të punës së ILD-së, edhe për shtrirje gjithëpërfshirëse gjeografike të inspektimit në gjykata e prokurori, Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve miratoi gjithsej 9 inspektime për t'u realizuar gjatë vitit 2026, 8 inspektime tematike dhe 1 inspektim institucional.

E veçanta këtë vit është miratimi i 2 inspektimeve tematike mbi ndjekjen e rekomandimeve të inspektimeve të mëparshme.

Nga trajtimi i ankesave të qytetarëve dhe institucioneve, kohëzgjatja e proceseve civile gjyqësore, shpallja dhe arsytimi i vendimeve gjyqësore, respektimi i afateve të paraburgimit, trajtimi i referimeve dhe kallëzimeve penale ndaj punonjësit të policisë së shtetit dhe atij të burgjeve për keqtrajtim, kalendar i inspektimeve për vitin 2026 përmban:

- Inspektimi tematik “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore”, do të kryhet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për periudhën 01.04.2025-30.06.2025. Ky inspektim, propozim i Ministrit të Drejtësisë do realizohet në periudhën kohore 16.02.2026 – 30.09.2026.
- Inspektimi tematik “Trajtimi i referimeve dhe kallëzimeve penale ndaj punonjësve të policisë së shtetit dhe policisë së burgjeve për torturë, keqtrajtim, veprime arbitrare apo dhunë të çdo lloji forme” do kryhet në të gjitha zyrat e prokurorive në vend për periudhën 01.01.2025 – 31.12.2025. Inspektimi, propozim i Prokurorit të Përgjithshëm, do realizohet në periudhën 16.02.2026 – 02.12.2026.
- Inspektimi tematik “Mbi kohëzgjatjen e proceseve civile gjyqësore të përfunduara me palë kundërshtarë”, do të realizohet në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për periudhën 01.04.2025- 30.06.2025. Inspektimi, propozim i Ministrit të Drejtësisë do kryhet në periudhën kohore 16.02.2026 – 30.10.2026
- Inspektimi tematik “Respektimi i afateve të paraburgimit në kuadër të shuarjes së masave të sigurimit gjatë fazës së hetimit” do të kryhet në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për periudhën 2023-2025. Inspektimi, propozim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë do kryhet në periudhën kohore 16.02.2026 – 30.10.2026
- Inspektimi tematik “Ndarja e çështjeve me short, si dhe kontrolli i raporteve të sistemit elektronik”, që do të realizohet për periudhën 01.01.2025-31.12.2025, në Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë, Lezhë dhe Vlorë. Inspektimi pranë këtyre gjykatave do të kryhet në periudhën 02.2026 – 10.12.2026.
- Inspektimi tematik “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve” për periudhën 01.01.2025-31.12.2025. Inspektimi do të kryhet në të gjitha zyrat e prokurorive në periudhën 16.02.2026 – 21.12.2026.
- Inspektim institucional “Infrastruktura dhe qarkullimi i dokumentacionit”, do kryhet në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm për periudhën 01.04.2025 – 30.06.2025. Inspektimi do realizohet në periudhën 16.02.2026 -30.10.2026

Në mënyrë të posaçme gjatë vitit 2026 janë miratuar dy inspektime për ndjekjen e rekomandimeve të inspektimeve të mëparshme, konkretisht:

- Inspektim vijues tematik mbi ndjekjen e rekomandimeve të inspektimit tematik miratuar me raportin nr. 56/29, datë 29.12.2023 për “Lirimin me kusht” në të gjitha gjykatat dhe prokuroritë për periudhën 16.02.2026 – 30.10.2026
- Inspektim vijues tematik mbi ndjekjen e rekomandimeve të inspektimeve tematike miratuar me raportet nr. 608/4, datë 22.04.2024 dhe nr. 2495, datë 09.09.2025 “Mbi caktimin e çështjeve me short në prokurori”, do të kryhet në të gjitha zyrat e prokurorive për periudhën 02.2026 – 31.07.2026. Inspektimi do të kryhet në periudhën 16.02.2026 – 30.09.2026.

ILD PËRFUNDON VERIFIKIMIN PËR ZBATIMIN E LIGJIT PËR AMNISTINË, TË VITIT 2024



Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka finalizuar verifikimin e iniciuar kryesisht për zbatimin e ligjit nr.33/2024 “Për dhënie amnistie”, bazuar në të dhënat e administruara në kuadër të këtij verifikimi pranë gjykatave dhe zyrave të prokurorive, si dhe informacionit të shfaqur në disa media mbi problematika në zbatimin e këtij ligji.

Iniciativa e ILD-së ka ardhur për zbatim të drejtë dhe efektiv të qëllimit që kanë nismat penale për dhënie amnistie, në respektim të parimit të humanizmit të drejtësisë penale, si dhe rehabilitimit dhe ri integritetit në shoqëri të të dënuarve bazuar edhe në standardet e vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Për këtë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka administruar nga Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve, të dhëna mbi problematika të mundshme të konstatuara gjatë zbatimit të këtij ligji, sa i takon zbardhjes së vendimeve gjyqësore; nxjerrjes së urdhrave të ekzekutimit nga prokurori; si dhe çështje të tjera që lidhen me veprimtarinë e magjistratëve, duke iniciuar më pas, verifikimin me iniciativë të informacionit në veprimtarinë e magjistratëve për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si dhe duke ushtruar kontroll në veprimtarinë e disa zyrave të prokurorisë dhe disa gjykatave për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit dhe arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Në përfundim të këtij verifikimi u konstatuan disa problematika:

- Konfuzion në interpretimin e dispozitave që lidhen me fillimin e ekzekutimit nga ana e prokurorit;
- Mosveprim i menjëhershëm pas administrimit të vendimit të shkurtuar, për nxjerrjen e urdhrave të ekzekutimit;
- Mënyra të ndryshme të të kuptuarit dhe të zbatuarit të dispozitave procedurale penale mbi shpalljen e vendimit të përmbledhur nga gjykatat;
- Konstatim i diferencës kohore midis datës së vendimit të formës së prerë dhe përcjelljes së tij;
- Mospërputhje e datës së hyrjes së vendimit në sekretarinë e prokurorisë me datën e marrjes në dorëzim nga prokurori si dhe datën e shkresës përcjellëse të këtij urdhri;
- Mos pasqyrim në librat e brendshëm të dorëzimit, të datës së marrjes në administrim nga prokurori i ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë të përcjella dhe të protokolluara.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka analizuar veprimtarinë e gjykatave dhe zyrave të prokurorive të konstatuara gjatë verifikimit në raport me kuadrin ligjor në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale, jurisprudencës kushtetuese, duke evidentuar problematika, të cilat duhet të mbahen në vëmendje nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, të gjitha gjykatat e shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm dhe zyrave të prokurorive pranë tyre.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë thekson domosdoshmërinë e respektimit të afateve ligjore dhe bashkërendimit të veprimtarisë së institucioneve përgjegjëse për ekzekutimin e vendimeve penale, për të garantuar njohjen dhe zbatimin e të drejtave të njohura për çdo kategori, të paraburgosur apo të dënuar sipas legjislacionit të posaçëm, ndërsa kërkon vëmendje të shtuar, kur miratohen nisma si ligji për amnistinë, nga ana e zyrave të prokurorive, gjykatat dhe IEVP-të, për të qenë rigorozë në zbatimin e kërkesave ligjore dhe afateve procedurale, për të mos sjellë pasojë në përfundimin e të drejtave dhe lehtësive të njohura nga ky ligj.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë vëren se problematikat e evidentuara nga verifikimi i praktikës së zbatimit të ligjit “Për dhënie amnistie” nga gjykatat dhe zyrat e prokurorive, duhet të jenë objekt diskutimi dhe trajtimi respektivisht në Mbledhjen e Përgjithshme të Gjyqtarëve dhe nga Drejtuesi i zyrave të prokurorisë.

Në përfundim, Inspektori i Lartë i Drejtësisë informon se varësisht nevojave të sistemit, detyrimeve ligjore, adresimit të problematikave më të shpeshta të hasura tek ankesat, prioriteve të punës së institucionit dhe kapaciteteve institucionale, do të vlerësojë në vijim kryerjen e një inspektimi tematik pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, gjykatave të shkallëve të para të juridiksionit të përgjithshëm, zyrave të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm mbi procedurën dhe afatet e ekzekutimit vendimeve penale.

SHKURTI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit shkurt 2026 Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **210 ankesa**, nga ta cilat **208 ankesa të depozituara nga qytetarë dhe 2 nga institucione**. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit shkurt 2026.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
64 vendime nga 139 praktika të trajtuara: · 51 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar · 13 vendime arkivimi pas verifikimit	19 vendime verifikimi	1 vendim për fillim hetimi disiplinor për 1 magjistrat (gjyqtar)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankese, i cili:

- mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr. 13, Tiranë;
- mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

INSPEKTORI I LARTË DREJTËSISË
BULETINI MUJOR



Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00 - 14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare.

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



KLGJ PRANON PJESËRISHT KËRKESËN E ILD PËR MASË DISIPLINORE NDAJ MAGJISTRATIT SH.L.



Këshilli i Lartë Gjyqësor ka pranuar pjesërisht kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masë disiplinore ndaj magjistratit Sh. L., për zvarritje të përsëritur në zbardhjen e vendimeve gjyqësore. Propozimi i ILD-së për caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, u pranua pjesërisht, duke u pranuar shkelja disiplinore e duke u caktuar ndaj gjyqtarit masa disiplinore “Vërejtje publike”.

Hetimi disiplinor ndaj Sh.L., gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë, Juridiksioni i Përgjithshëm Sarandë, nisi bazuar në 12 ankesa për zvarritje në zbardhjen e vendimeve të arsyetuara nga gjyqtari, shkelje disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “d” i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raporti voluminoz i hetimit të inspektorëve të ILD-së, me dy procedime të bashkuara e objekt hetimi të shtuar për gjyqtarin, evidentoi vonesa të përsëritura të zbardhjes së vendimeve në tejkalim të afatit ligjor deri në 4 vite, vendime që i përkasin periudhës së viteve 2021, 2022, 2023. Raporti i inspektorëve të ILD-së konkludoi nga ana e magjistratit janë ndërmarrë veprime/mosveprime në shkelje të afateve procedurale civile dhe penale të arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke tejkaluar afatet tej çdo llogjike, ku mosrespektimi i afateve ligjore nuk paraqitet si episod i izoluar, por si model i përsëritur në tri vite radhazi dhe në përmasa jashtë çdo standardi ligjor dhe profesional të afateve të vonesës.

Zvarritja sistematike dhe e përsëritur përtej këtyre afateve, përbën tregues të qartë të mosrespektimit të përgjegjësiwe funksionale.

Pavarësisht parashtrimeve të magjistratit lidhur me ngarkesën në punë dhe për gjendjen e sistemit gjyqësor, nga analiza e situatës rezultoi se ai nuk ka përmbushur në mënyrë të plotë dhe të qëndrueshme detyrimet ligjore dhe funksionale, që i ngarkohen për arsyetimin dhe dorëzimin në kohë të vendimeve gjyqësore.

Në raportin hetimor vërehet se shkelja disiplinore e gjyqtarit ka sjellë mos marrje në kohë të produktit të pritshëm nga gjykimi i një çështjeje të caktuar, vonesa në ushtrimin e të drejtës së ankimit apo edhe vonesa të theksuara në ekzekutimin e vendimit gjyqësor, si pasojë e mosarsyetimit në kohë të vendimeve, pra një drejtësi e mohuar.

Duke marrë parasysh eksperiencën e pakët 5 vjeçare në sistem, Inspektori i Lartë i Drejtësisë konkludoi se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Sh.L., përbëjnë “Shkelje të rëndë disiplinore” dhe i propozoi Këshillit të Lartë Gjyqësor caktimin e masës disiplinore “Ulje e përkohshme e pagës deri në 40 për qind, për një periudhë jo më të gjatë se një vit”, parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “c”, ndarja “i” dhe neni 108 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Këshilli i Lartë i Drejtësisë njohu shkeljen disiplinore dhe caktoi masën “Vërejtje publike” ndaj gjyqtarit Sh. L.

ILD MORI PJESE NË TRYEZËN NDËRINSTITUCIONALE PËR KLIMËN DHE DREJTËSINË MJEDISORE NË SHQIPËRI



Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në Tryezën Kombëtare për Konvergjencën mbi Drejtësinë Klimatike dhe Mjedisore, organizuar nga Agjencia Franceze e Zhvillimit dhe Expertise France, me drejtues të institucioneve publike, ekspertë dhe përfaqësues të shoqërisë civile nga fushat e drejtësisë dhe mjedisit, me synimin për të forcuar qasjen në drejtësinë klimatike dhe mjedisore dhe bashkëpunimin ndërinstitucional.

Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani

Mirëmëngjes të gjithëve dhe faleminderit për ftesën,

Më lejoni të shpreh konsideratat dhe vlerësimin tim në këtë tryezë ndërinstitucionale për Klimën dhe Drejtësinë Mjedisore në Shqipëri që Projekti Expertise France ka organizuar, duke na paraqitur edhe draft planin e veprimit me objektivat konkretë.

Ndihem mirë në këtë tryezë së pari për shkak të formimit dhe interesit tim profesional mbi të drejtën mjedisore dhe së dyti për shkak të institucionit që përfaqësoj dhe punës që kemi bërë në raport me këtë çështje. Më duhet të them se në gjashtë vite veprimtari, Inspektori i Lartë i Drejtësisë nuk ka marrë asnjë ankesë për gjyqtarë a prokurorë për çështje që lidhen me mjedisin. E nga ana tjetër, as nga institucionet nuk ka patur ndonjë kërkesë apo referim për inspektim tematik a institucional të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në trajtimin e krimit mjedisor nga gjykatat e prokuroritë. Dhe është mëkat mospërdorimi i këtyre mekanizmave referuese nga institucionet apo aktorë të tjerë, të cilat i garanton kushtetuta.

Vetë Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka bërë më shumë se kaq. Ka qenë pjesë aktive e projektit të Komisionit Evropian “Bashkëpunimi në mbrojtjen e mjedisit përmes autoriteteve kombëtare të inspektimit të drejtësisë”(COPEIJ), projekt që bashkoi përfaqësues të Inspektoratit të Përgjithshëm Francez të Drejtësisë, Inspektoratit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë të Italisë, Këshillit Gjyqësor të Portugalisë, Inspektoratit Gjyqësor të Rumanisë dhe Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të Shqipërisë, anëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë (RESIJ), nën kujdesin e Expertise France.

Për dy vite me rradhë, 2022-2024, përmes këtij projekti shërbimet kombëtare të inspektimit të 5 vendeve të RESIJ u angazhuan në kuadër të direktivës së re të Bashkimit Evropian të 11 prillit 2024 për mbrojtjen e mjedisit nëpërmjet ligjit penal, duke inkurajuar reflektimin mbi mënyrën e përmirësimit të drejtësisë në fushën mjedisore, për të zhvilluar burime, veçanërisht ato procedurale, për të promovuar konvergjencën e strategjive kombëtare për të luftuar krimin mjedisor dhe për të përmirësuar koordinimin e shërbimeve kompetente, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë evropian.

Më vjen mirë që draft plani i veprimit që Expertise France paraqitet sot me objektivat dhe hapa konkretë, ka pikëtakime me gjetjet dhe rekomandimet që Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë në raportin për Shqipërinë në kuadër të COPEIJ.

Drejtësia mjedisore është mbrojtja e barabartë dhe përfshirja e të gjithë individëve në lidhje me zhvillimin, zbatimin e ligjeve, rregulloreve dhe politikave mjedisore, si dhe shpërndarjen e barabartë të përfitimeve mjedisore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë njeh dhe garanton të drejtën e çdo personi për t'u informuar mbi gjendjen e mjedisit, si dhe mbi masat e ndërmarra nga autoritetet shtetërore për mbrojtjen e tij. Paralelisht me këtë të drejtë, shtetit i ngarkohet detyrimi kushtetues për të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme me qëllim garantimin e një mjedisi të pastër dhe të shëndetshëm, në interes të shoqërisë në tërësi.

Këto detyrime kushtetuese janë të konkretizuara në akte të rëndësishme ligjore, përfshirë Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, i cili siguron mbrojtje juridiko-penale të mjedisit përmes kriminalizimit të veprimeve dhe sjelljeve të kundërligjshme që e dëmtojnë atë. Legjislacioni penal shqiptar është harmonizuar me Direktivën e Bashkimit Evropian 2008/99/EC “Për mbrojtjen e mjedisit përmes ligjit penal”, duke shërbyer si një mekanizëm për rritjen e ndërgjegjësimit të aktorëve të ndryshëm, ndëshkimin e veprimtarive të paligjshme dhe parandalimin e kryerjes së veprave penale mjedisore.

Edhe kuadri ligjor rregullator në fushën e mbrojtjes së mjedisit, i përafëruar në masë të madhe me *acquis communautaire* të Bashkimit Evropian, së bashku me ratifikimin e marrëveshjeve shumëpalëshe mjedisore dhe aderimin në konventa ndërkombëtare, dëshmon rëndësinë që Shqipëria i kushton bashkëpunimit ndërkombëtar për çështjet e mbrojtjes së mjedisit.

Megjithatë, pavarësisht këtij progresi normativ, problematikat kryesore lidhen me zbatimin efektiv të këtij kuadri në praktikë. Një pjesë e konsiderueshme e akteve ligjore dhe nënligjore nuk shoqërohen me raporte të rregullta monitorimi dhe vlerësimi të zbatimit, çka e bën të vështirë matjen reale të efektivitetit të tyre.

Legjislacioni mjedisor në shumë raste rezulton më i avancuar se kapacitetet administrative, financiare dhe institucionale të strukturave përgjegjëse për zbatimin e tij. Kjo mospërputhje reflektohet në mungesën e progresit të qëndrueshëm në fusha kyçe si përgjegjësia mjedisore, inspektimi mjedisor dhe ndëshkimi i krimit mjedisor. Si pasojë, zbatimi i ligjit shpesh mbetet formal dhe reagues, më tepër sesa parandalues dhe sistematik.

Bashkimi Evropian në raportet e progresit për Shqipërinë evidenton një rritje të hetimeve në fushën e krimeve mjedisore, por thekson nevojën për forcimin e mbrojtjes së mjedisit, veçanërisht në proceset e miratimit të investimeve private dhe në garantimin e integritetit të zonave të mbrojtura dhe habitateve të specieve të veçanta. Ky vlerësim tregon se progresi është i pjesshëm dhe ende i brishtë.

Politika penale aktuale, e fokusuar kryesisht në dënimin me gjobë, rezultojnë shpesh joefektive, veçanërisht në rastet kur autorët e veprave penale i përkasin shtresave me probleme socio-ekonomike. Në këto kushte, gjobat janë jo vetëm të papërbalueshme, por edhe të paafëta për të përmbushur funksionin e tyre parandalues. Për rrjedhojë, politika penale duhet të rishikohet duke u orientuar jo vetëm drejt ndëshkimit, por edhe drejt edukimit, rehabilitimit dhe parandalimit të përsëritjes së veprave penale.

Procesi i integritetit të vendit tonë në Bashkimit Evropian dhe veçanërisht negociimi i Kapitujve mbi Drejtësinë dhe të Drejtat Themelore (Kapitulli 23), dhe “Mjedisi dhe ndryshimet klimatike” (Kapitulli 27) kërkojnë një veprim transformues bazuar në shtetin e të drejtës, si dhe respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave mjedisore. Por vetëm përafrimi i legjislacionit vendas me direktivën e Bashkimit Evropian “Për Mbrojtjen e Mjedisit përmes Ligjit Penal” nuk është i mjaftueshëm në mbrojtjen dhe promovimin e drejtësisë mjedisore.

Miratimi i amendimeve ligjore duhet të shoqërohet edhe me mekanizmat e nevojshme, të cilat do të mundësojnë: rritje e ndërgjegjësimit të institucioneve edhe të publikut të gjerë mbi gamën e krimeve mjedisore; trajtimin fillestar dhe vazhdues të magistratëve për sa i takon veprave penale në fushën e mjedisit dhe jurisprudencës së GjEDNJ dhe GjED në këtë fushë; forcim të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet autoriteteve administrative me Gjyqësorin dhe Prokurorinë; përfshirjen e ekspertëve të fushës në gjykimin e çështjeve me objekt mbrojtjen mjedisore; përdorimin e politikave penale dhe administrative, që jo vetëm ndëshkojnë, por dhe parandalojnë dhe restaurojnë dëmin e shkaktuar.

Vetë qëllimi themelor i legjislacionit mjedisor duhet të mbetet parandalimi, i ndjekur nga ndëshkimi administrativ dhe, si masë e fundit, ndëshkimi penal. Përmbushja e këtij qëllimi kërkon jo vetëm një kuadër ligjor të harmonizuar, por mbi të gjitha kapacitete institucionale funksionale, politika penale efektive dhe një qasje gjithëpërfshirëse që kombinon kontrollin, ndëshkimin dhe edukimin. Vetëm në këtë mënyrë mund të flasim për efektivitet në promovimin e një drejtësie mjedisore, që do t'u shërbejë brezave të ardhshëm.

Ju faleminderit!



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË ZHVILLOI NJË VIZITË PUNE NË MAQEDONINË E VERIUT



Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z. Artur Metani, së bashku me një delegacion të zyrës së ILD-së ishte për një vizitë zyrtare në Shkup, ku zhvilloi takime pune me përfaqësues të Këshillit të Prokurorëve Publikë, Këshillit Gjyqësor, Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjatë këtyre takimeve u theksua rëndësia e angazhimit të përbashkët në konferencën rajonale “Shërbimet e inspektimit të drejtësisë dhe sfidat e integritetit”, e mbajtur në Tiranë më 25-26 shtator 2025, me mbështetjen e OSBE-së. Konferenca u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional për përballimin e sfidave profesionale, me qëllim rritjen e rolit të institucioneve të drejtësisë në garantimin e integritetit të sistemit gjyqësor dhe në rritjen e besimit të publikut.

Në Këshillin e Prokurorëve Publikë, z. Metani u prit nga Kryetari i Këshillit, z. Bashkim Besimi, nënkryetarja znj. Marjana Ilieska dhe anëtarë të Këshillit, z. Ermon Neziri. Bisedimet u përqendruan në mundësitë konkrete për thellimin e bashkëpunimit, përmes shkëmbimit të përvojave dhe ekspertizës, si dhe forcimit të kapaciteteve njerëzore, në funksion të konsolidimit të shtetit të së drejtës.

Më tej, z. Metani dhe delegacioni i ILD-së zhvilluan një takim në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, ku u pritën nga Kryetari, z. Aleksandar Kambovski, si dhe anëtarë të Këshillit.

Gjatë takimit, u vlerësua organizimi i konferencës rajonale në Tiranë si një përvojë e suksesshme që meriton të vijojë edhe në të ardhmen. Nga ana e tij, z. Metani iu përgjigj interesimit të anëtarëve të Këshillit, duke ofruar sqarime mbi aspekte të veçanta të veprimtarisë së ILD-së në tërësi, si dhe mbi procedurat e standardet që ndiqen në procesin disiplinor në veçanti.

Në takimin me Kryetarin e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, z. Adem Chuchulj, të cilin e uroi për zgjedhjen në krye të këtij institucioni, z. Metani theksoi rëndësinë e forcimit të bashkëpunimit ndërinstitucional në funksion të rritjes së integritetit dhe transparencës në sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, delegacioni i ILD-së zhvilloi një takim edhe me Kryetarin e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, z. Afrim Fidani, ku u diskutua mbi sfidat e përbashkëta institucionale dhe mundësitë për thellimin e bashkëpunimit profesional.

“Komunikimi efektiv, shkëmbimi i përvojave dhe trajtimi i hapur i sfidave profesionale forcojnë ndjeshëm rolin e institucioneve të drejtësisë në mbrojtjen e integritetit të sistemit gjyqësor dhe në rritjen e besimit të publikut. Për më tepër, këto përpjekje janë thelbësore për mbështetjen e procesit të vazhdueshëm të integritetit në Bashkimin Evropian”, u shpreh z. Metani. Pjesë e delegacionit të ILD-së ishin edhe përfaqësues nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, znj. Luljeta Krasniqi, si dhe nga Misioni i OSBE-së në Shkup, z. Arben Ajrulai.





TRUPA INSPEKTUESE E ILD TRAJNIM MBI METODAT E REFLEKTIMIT PROFESIONAL DHE DILEMAVE ETIKE



Njësia e Inspektorëve dhe Njësia e Ndhmës inspektorëve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë morën pjesë në trajnimin dy ditor mbi metodat e reflektimit profesional dhe dilemave etike, organizuar nga Qendra Holandeze e Trajnimit dhe Studimit për Gjyqësorin (SSR) me dy ekspertet e qendrës, znj. Anne Tahapary dhe znj. Floor Boekhorst.

Trajnimi është pjesë e praktikës së ILD-së për forcimin e kapaciteteve profesionale dhe tema e reflektimit profesional dhe e dilemave etike janë përbërës me rëndësi për inspektimin dhe procesin disiplinor të magjistratëve, tha mes të tjerash në nisje të trajnimit Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani, duke falenderuar ambasadën dhe qeverinë holandeze për bashkëpunimin e hershëm me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. “Metodat e reflektimit profesional dhe analiza e dilemave etike e transformojnë punën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, jo thjesht në aspektin e ngushtë ndëshkues disiplinor, por në një proces konstruktiv, edukues dhe parandalues, duke siguruar pavarësinë gjyqësore, forcuar besimin e publikut dhe nxitur drejtësi të paanshme dhe me cilësi të lartë. Qëllimi është të krijohet një kulturë e lartë etike dhe profesionale në sistemin e drejtësisë, ku ndjenja e llogaridhënies të jetë pjesë e vetëdijes së magjistratëve dhe jo një faktor i jashtëm.”, vërejtë z. Metani.

Në fjalën e saj përshëndetëse, e ngarkuara me punë e Ambasadës së Mbretërisë së Vendeve të Ulëta në Shqipëri, znj. Asli Cetinel tha mes të tjerash se “Me mbështetjen e Mbretërisë së Holandës, përmes projektit MATRA ‘Forcimi i Integritetit Gjyqësor në Shqipëri’, i zbatuar nga Qendra Holandeze për Trajnim dhe Studim të Gjyqësorit (SSR), ky aktivitet trajnon inspektorët dhe ndihmës-inspektorët në çështje të etikës, reflektimit profesional dhe synon të kontribuojë në përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë për forcimin e shtetit të së drejtës dhe rritjen e kapaciteteve institucionale.”

Trajnimi nisi me paraqitjen e kornizës teorike mbi standardet ekzistuese ndërkombëtare dhe ligjore dhe vijoi me hyrje në metodat e reflektimit profesional dhe dilemat etike, ku inspektorët dhe ndihmës inspektorët u njohën me një sërë metodash, që mund të përdoren për të diskutuar çështje etike, dilema profesionale dhe personale që mund të ndodhin në një mjedis pune.

Pjesa praktike e trajnimit vijoi me ushtrime konkrete mbi dilema morale, intervista, konsultim me kolegë etj.



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
BULETINI MUJOR



MBLEDHJA E INSPEKTORËVE ANGAZHOHET PËR ZBATIMIN E METODOLOGJISË SË VERIFIKIMIT TË ASETETEVE



Mbledhja e përgjithshme e Inspektorëve diskutoi mbi draft “Metodologjinë e verifikimit asetëve”, hartuar nga ekspertët e projektit EU4Justice.

Nevoja e hartimit të një metodologjie të tillë ka qenë e nxitur nga fazat e proceseve integruese që po kalon vendi ynë, me synim fundor, plotësimin e hapësirave apo mangësive të evidentuara për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”. Ky proces i nisur në vitin 2022, me progresin e arritur me qëndrimin e përbashkët të Bashkimit Evropian (Bruksel 11 tetor 2024), bazuar në Konferencën e Anëtarësimit me Shqipërinë (AD 5/22 CONF-ALB), në bashkëpunim me organet kompetente e udhëheqëse të koordinimit të politikave për këtë proces ka përcaktuar edhe në një sërë dokumentesh strategjikë ndërinstitucionalë të brendshëm, edhe si angazhime politike në kuadër të anëtarësimit, duke kërkuar edhe angazhimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në aspektin e rishikimit të praktikave të brendshme të punës për të integruar standardet e larta të ndjekura nga organet e procesit të rivlerësimit kalimtar.

Për këtë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë i është drejtuar për asistencë teknike Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit dhe projektit EU4Justice, me synim përjasjen e metodës së punës me praktikat e mira të punës.

Me asistencën e partnerëve ndërkombëtarë, ekspertë të ONM dhe Eu4Justice, është finalizuar drafti i metodogjisë së vlerësimit të asetëve, lidhur me të cilën është organizuar edhe një trajnim dyditor me pjesëmarrjen e ekspertit të projektit EU4Justice dhe pjesëmarrjen e inspektorëve, ndihmës inspektorëve dhe anëtarëve të Kabinetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve e shqyrtoi dhe e vlerësoi këtë dokument teknik dhe orientues të pasuruar me shembuj praktikë dhe u angazhua për ta aplikuar këtë metodologji për aq sa është e mundur, gjatë ushtrimit të kompetencave që parashikon legjislacioni në fuqi për veprimtarinë hetimore dhe verifikuese të kriterëve ligjore të kandidatëve për inspektorë jo magjistratë në respektim të parashikimeve të nenit 124/1 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe në kuadër të verifikimit përbushjen e kushteve ligjore të kandidatëve për inspektorë sipas nenit 209 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 536, datë 25.7.2019 “Për krijimin e kushteve për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jo magjistratë për pozicionin e inspektorit”.

SHPALLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit Shkurt 2026, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, për **10 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuesi të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuesin për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: info@ild.al, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit elis.kuci@ild.al

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

*Gjatë muajit **Shkurt 2026**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **24 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuesit t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER



SHKURT 2026


Të gjitha të drejtat e rezervuara
© ILD



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

KONTAKT

WEB: ild.al
TEL: +35542217217
EMAIL: info@ild.al
ADRESA: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Godina nr. 13, Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)



Më skano!